



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:158219
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05626235

Ac.nr.4459/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca - Dula dhe Ylber Shurdhiqi, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Organizata Komunale e Pensionistëve në Lipjan, rruga “Lidhja Prizrenit”, p.nr., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson R.R., avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Behar Krasniqi, për vërtetimin e pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.547/16 të datës 25.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditëses Organizata Komunale e Pensionistëve në Lipjan, rruga “Lidhja Prizrenit”, p.nr., PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.547/16 të datës 25.02.2020 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.547/16 të datës 25.02.2020, në pikën I (një) të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses Organizata Komunale e Pensionistëve në Lipjan, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se është pronare e paluajtshmerisë e cila gjendet në ndërtesën banesore P+4, hyrja e I, në pjesën përdhese, e cila përfshin dy banesa dhe dy lokale afariste, kafenenë, bufenë, hapësirën shoqërore, dy zyre për shoqatë të pensionistëve e dy për invalid të punës, WC për kafene, WC për hapësirë shoqërore

dhe administratë, në sipërfaqe të tërësishme prej 104 m², dhe të detyrohet e paditura që paditëses t' ia njoh të drejtën e pronësisë në këtë paluajtshmëri dhe të lejoj regjistrimin e të drejtës së pronësisë në regjistra të paluajtshmërive në zyrën komunale për kadastër në Lipjan, në pronësi të paditëses, në të kundërtën kjo e drejtë do të regjistrohet në bazë të këtij aktgjykimi si dhe të kompensohen shpenzimet e procedurës kontestimore. Në pikën II (dy) të dispozitivit ka vendosur që secila palë ndërgjyqësore t'i bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesën ta aprovojë si të bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të aprovohet si e bazuar apo i njëjti të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 15.12.2016 paditësja nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, për vërtetimin e pronësisë, me arsyë dhe kërkesë si në padinë e ushtruar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.547/16 të datës 25.02.2020, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditësja Organizata Komunale e Pensionistëve të Lipjanit është OJQ e themeluar, përkatësisht e regjistruar me dt. 26.12.2013, si Organizate Joqeveritare e regjistruar në Departamentin e Regjistrimit të ndërlidhjes së OJQ-eve të Ministrisë së Administratës Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, OJQ kjo e themeluar pas viteve 1999 dhe se kërkesë për njohjen e të drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese, përveç paditëses Organizata Komunale e Pensionistëve në Lipjan, kanë paraqitur edhe Organizata Komunale e Pensionistëve Invalidor të Punës dhe Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës së Kosovës-Dega në Lipjan, edhe këto të dyja si OJQ të formuara pas luftës së vitit 1999. Në fund ka shtuar se mbi këtë gjendje faktike gjykata ka ardhur në përfundim se paditëses-Organizata Komunale e Pensionistëve në Lipjan i mungon legjitimiteti real aktiv për të qenë palë në këtë çështje kontestimore, pasi që me asnjë provë të vetme të paraqitur nuk arriti të dëshmoj se është pasardhëse legjitime e Organizatës së Pensionistëve në Lipjan, e cila organizatë ka ekzistuar para luftës së vitit 1999, përkatësisht për të cilën BVI-ja për banim në Lipjan, në marrëveshje me kompaninë "Ulpiana" në Lipjan, kanë ndërtuar objektin kontestues në Lipjan.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, gjendja faktike nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar.

Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, për shkak se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit, respektivisht në arsyetim të aktgjykimit nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare. Ndërlidhur me këtë aktgjykimi është i përfshirë në shkelje edhe nga neni 182 paragrafi 1, lidhur me nenin 160 paragrafi 5 i LPK-së, për shkak se gjykata e ka përfunduar çështjen kontestuese duke nxjerrë aktgjykim meritore pa treguar-arsyetuar se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Pra në këtë rast gjykata nuk ka dhënë asnjë referencë në asnjë normë materialo-juridike për kualifikimin e fakteve lidhur me vendosjen meritore të çështjes. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshtet të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave të administruara, por nuk ka arsye bindëse se pse paditëses në rastin konkret i mungon legjitimiteti real aktiv për të qenë palë në këtë çështje juridike kontestimore.

Nën rrethanën e tillë, Gjykata e Apelit të bazuara i vlerëson edhe pretendimet ankimore të palës ankuese për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase gjykata e shkallës së në procedurën e provave ka administruar provat, të cilat në arsyetimin e aktvendimit të ankimit ka përshtet të tyre dhe çfarë ka vërtetuar nga secila provë veç e veç por gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të vërtetojë lidhshmërinë e këtyre provave në raport me çështjen kontestuese dhe me normat materiale juridike, e rrjedhimisht edhe me çështjen e mungesës së legjitimitetit të palës paditëse.

Nga arsyet e cekura dhe për shkak të shkeljeve të sipër theksuara rezulton se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, aq më tepër kur nuk dihet fare mbi cilat norma materialo-juridike gjykata ka arritur në përfundimin për refuzimin e kërkesëpadisë.

Për shkak të mangësive të evidentuara më lart, e që i referohen shkeljes së dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së dhe konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, por është dashur që i njëjti të priset dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Andaj udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që fillimisht të administrojë prova në drejtim të të provuarit të legjitimitetit real të palës paditëse, të vërtetojë gjendjen faktike, duke i vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm për këto pretendime dhe tek pas sqarimit të të gjitha fakteve, të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj për këtë çështje juridike. Në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 160

të LPK-së. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 4459/20, me datë 17.04.2024.

Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka d.v.